**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**

*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +355222400150*

Nr.3184 Prot                                                            Shkodër, më 21/ 03/ 2016

**VENDIM**

**Nr.175 Datë 21 03 /2016**

**Për miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave publike**

Në mbështetje ligji nrNr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e taksave Vendore", i ndryshuar, ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", VKM. Nr. 1096 datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike", Ligji nr. Nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, VKB nr.1 datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër",

**VENDOSA:**

1. Miratimin e rregullores për shfrytëzimin e hapësirave publike, bashkengjitur materiali.
2. Ky vendim i njoftohet Këshillit Bashkiak Shkodër dhe Prefektit të Qarkut Shkodër.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë, Kryetarët e Rajoneve dhe Administratorët e Njësive administrative, të përfshira në këtë rregullore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**

*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +355222400150*

# RREGULLORE

# "PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE"

## Baza Ligjore

Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
Ligji Nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar
Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e taksave Vendore", i ndryshuar
Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit";
VKM. Nr. 1096 datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike";
Ligji nr. Nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore;
VKB nr.1 datë 22.1.2016 "për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër";

## Neni 1
## Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat, kushtet e procedurat për përdorimin, shfrytëzimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.

## Neni 2
## Objekti

Objekt i kesaj regullore janë të gjitha hapësirat publike në pronësi të Bashkisë Shkodër.

## Neni 3
## Përkufizime
## Hapesira Publike

Hapësirë publike, është hapësira e jashtme, si trotuari, sheshi, lulishtja, parku dhe të tjerë të ngjashme në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht regjimit juridik të tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit"

## Neni 4
## Perdorimi i hapësirave publike

Hapësira publike është pronë e përbashkët, që i përket komunitetit ku jetojmë, dhe të gjithë ne jemi të barabartë kundrejt përdorimit të saj.
Është e ndaluar zënia e hapësirës publike në mënyrë të përkohshme edhe përhershme, me çfarëdo lloj objekti, mbi ose nën të, pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo autoritetit përgjegjës për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.

## Neni 5
## Leje e Shfrytëzimit

a) Lejet e shfytëzimit të hapësirave publike jepen për një përiudhe jo më të vogël se 6 muaj dhe jo më të madhe se 1 vit, dhe kanë të drejtë rinovimi.
b) Lejet e shfrytezimit të hapësirave publike jepen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

## Neni 6
## Rregullat e shfrytëzimit të hapësirës për Bare, Restorante ose vende shërbimi.

Subjekti, në perputhje me rregulloren dhe ligjet në fuqi, duhet të shfrytëzojë hapësirën publike, sipas miratimit të bëreë

a) duhet të riparojë me shpenzimet e veta të gjitha dëmtimet që rezultojnë nga përdorimi ose keqpërdorimi i hapësirës publike të dhënë;
b) të siguroje, me shpenzimet e veta dhe në kushte optimale sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim dhe atë rreth saj si nga ana e pastërtisë dhe funksionalitetit;
c) të kujdeset që objektet e vendosura në sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim të jenë në gjëndje të mirë si nga ana funksionale dhe ajo estetike;
d) të përdorë hapësirën publike në menyrë të tillë që të mos kufizojë, shkaktojë dëme ose të shkelë të drejtat e paleve të treta;
e) të shmange krijimin e situatave të rrezikshme ose të pengimit të qarkullimit të mjeteve dhe kalimit të këmbësorëve;
f) të mos shfrytezojë hapesirë më të madhe se fasada e ambjentit qe ai disponon;
g) të bëje pagesën e tarifës brenda afateve të përcaktuara;
h) në momentin që subjekti nuk ka më të drejtë për shfrytëzimin e hapësirës publike si rrjedhoje e mos zbatimit të detyrimeve ose nëpërmjet kërkesës së tij, ta kthejë këtë hapësirë në gjëndje funksionale sic ishte para marrjes në dorëzim;

## Neni 7
## Shfrytëzimi i hapësirave publike për tregtimin e artikujve të ndyshëm

Shfrytëzimi i hapësirës publike, për tregtimin e artikujve të ndryshëm, biznese të tjera të ngjashme apo shitës ambulant, lejohet, si më poshtë:

a) Përdorimi i hapësirës nga shitësit ambulant, lejohet vetëm ne rastet kur ato janë të grupuar në tregje, në hapësira të përcaktuara nga pushteti lokal.
b) Nuk lejohet vendosja e kioskave, përvec vendeve të përcaktuara nga autoriteti vendor.
c) Aprovimi i vendodhjes do shoqërohet me modelin e kioskes respektive si dhe detyrimet që përfituesi do të ketë, për përdorimin e kësaj hapësires publike.
d) Këto biznese (dyqan, tregtimi i artikujve të ndryshëm, biznese të ngjashme) janë të detyruara të kryejnë veprimtarinë e tyre, brenda hapesirës, ambjentit që zotërojne, (kanë në përdorim), duke mos cënuar në asnjë mënyrë, hapësirën publike.
e) Ekspozimi i produkteve të tregtuara, duhet të bëhet vetëm brenda fasadës së ambjentit, ku biznesi ushtron aktivitetin dhe jo jashtë saj.
f) Gjithashtu për çdo element të shtuar të fasadave respektive, që është pjesë e hapësirës publike, sikurse tenda, cadra, reklame etj, nevojitet leje nga autoritetet përkatëse.

## Neni 8
## Dokumentet e kerkuara, për fillimin e procedurave, për dhenien e lejes së shfrytetimit së hapesires publike

1. Subjektet e interesuara, duhet të paraqesin në Zyrën me një ndalesë (Z1N) dokumentet e mëposhtme;
    a. Fotokopje të mjetit identifikues
    b. Kërkesë për paisjen me leje shfrytëzimi (formular nr.1)
    c. Çertifikatën e regjistrimit të subjektit;
    d. Vërtetim që subjekti nuk ka detyrime vendore;
    e. Fotokopje të librezës së ujit (duhet të mos ketë detyrime deri në ditën e aplikimit);
    f. Dy foto në këndet e ndyshme të hapësirës ku të kuptohet si fasada e ambjentit si dhe hapësira para sajë (trotuari).
1. Në rastet kur aplikimi për pajisje me leje shfrytëzimi të hapësirës publike ka mangësi në dokumentacion, leja refuzohet.
2. Kërkesat paraqiten pranë zyrës me një ndalesë, pranë Bashkisë Shkodër.
3. Subjekti paiset me leje shfrytzimi,pasi të kryejë detyrimet e pagesave për hapësiren të cilën kërkon të marrë në shfrytëzim.

**Neni 9**
**Afatet**

a) Bashkia Shkodër del me vendim Brenda 10 ditëve për dhënien apo jo të shfrytëzimit të hapësirave publike.
b) Afati 10 ditor përjashtohet atëherë kur kerkuesi nuk plotëson detyrimet financiare dhe në rastet kur zonat e kerkuara nuk janë zona me studime plani. Moszbatimi i afateve konsiderohet shkelje dhe shoqërohet me masë disiplinore “shkelje e lehtë”.

**Neni 10**
**Detyrat e drejtorise e studimeve planifikimit, kordinimit të investimeve**

c) Drejtoria e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve realizon planin e shfrytëzimit të hapësirës publike në të gjithë territorin e Bashkise ose në një pjesë të saj të specifikuar në këtë rregullore dhe që nuk bie ne kundershtim me të.

d) Ne rastet kur paraqiten kërkesa per shfrytezimin e hapësirave publike në zona që nuk janë perfshirë në plane, në Drejtorinë e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit merr në shqyrtim brenda 15 ditëve kërkesat dhe në rast kur kërkesa nuk bie në kundershtim me ligjet në fuqi dhe këtë rregullore i propozon Kryetarit të Bashkisë që kjo zonë te përfshihet në planin e shfrytëzimit të hapesirave publike.

**Neni 11**
**Detyrat e Drejtoria e Kontrollit te Zhvillimit të Territorit**

a) Drejtoria e Kontrollit te Zhvillimit të Territorit shqyrton kërkesen, nëse kjo kërkesë është në përputhje me këtë rregullore dhe ligjet në fuqi.

b) Drejtoria e Kontrollit te Zhvillimit të Territorit pasi verifikon kërkesen nëse është në përputhje me rregulloren, përcaktimet dhe specifikimet teknike pjesë e kësaj rregulloreje, prodhon hartën të cilën ia dërgon Drejtorisë së të Ardhurave.

c) Në momentin e dhënies të lejeve të shfrytëzimit, pwrcillet dhe u komunikohet zyrtarisht kryetarëve të rajoneve, administratorëve të njësive administrative si dhe drejtorisë së IT.

**Neni 12**
**Detyrat e Dejtorisë së të ardhurave**

a) Drejtoria e të ardhurave verifikon që nuk është debitor për detyrimet vendore.

b) Drejtoria e të ardhurave faturon detyrimet për hapësirat dhe siguron që fatura të shlyhet përpara dhënies së lejes së shfrytëzimit.

c) Drejtoria e të ardhurave kryen inspektimet veçmas ose në bashkëpunim me kryetarët e rajoneve dhe administratoret.

d) Inspektorët e terrenit të Drejtorisë së të ardhurave aplikojnë gjobat për çdo subjekt apo individ në rastet e shkeljeve të konstatuara nga ana këtyre të fundit.

**Neni 13**
**Detyrat e Kryetareve te Rajonit dhe Administratorëve**

a) Kryetarët e rajoneve dhe administratorët e njësive administrative do të sigurojnë që subjektet zbatojnë me korrektësi sipërfaqen të cilën kanë marrë në përdorim.

b) Kryetarët e rajoneve, inspektorët e rajonit dhe administratorët e njësive administrative kryejnë inspektime dhe mbajnë proçesverbal konstatimi të situatës në tërësi dhe në veçanti për secilin subjekt jo më pak se 1 herë në muaj.

c) Kryetarët e rajoneve dhe administratorët e njësive administrative raportojnë pranë kryetarit për çdo rast të zënies së hapësirave publike në mënyrë jo të ligjshme.

d) Mos kryerja e këtyre detyrimeve konsiderohet shkelje e rëndë për kryetarët e rajoneve,  administratorët e njësive administrative dhe inspektorët e rajoneve.

**Neni 14**
**Detyrat e Policisë Bashkiake**

a) Policia Bashkiake ka detyrë të jetë në çdo rast në mbështetje të kryetarëve të rajoneve apo inspektorëve të taksave në rastet kur këta të fundit e shohin të nevojshme prezencën e saj.

b) Policia Bashkiake në rastet e shkeljeve të lejes së shfrytëzimit të hapësirave publike ka detyrën të lirojë sheshet dhe hapësirat publike.

e) Policia bashkiake aplikon gjobat për çdo subjekt apo individ në rastet e shkeljeve të konstatuara nga ana këtyre të fundit.

**Neni 15**
**Drejtoria e IT**

Drejtoria e IT bën publikimin në faqen zyrtare të lejes së shfrytëzimit të hapësirës publike dhe hartën e vendodhjes.

**Neni 16**
**Marreveshjet**

a) Marrëveshja të cilat do lidhen mes subjektit kërkues dhe Bashkisë Shkodër, ka si qëllim përcaktimin e kritereve të bashkëpunimit në fushën e ruajtjes, mirëmbajtjes dhe shërbimit të hapësirave publike në shfrytëzim dhe përreth zonës në të cilën ushtrojnë aktivitet.

b) Kjo marrëveshje bëhet simbas (sipas) rëndesisë së zonave dhe kategorive të përcaktuara në këtë rregullore.

c) Modelet tip të marrëveshjeve përcakton me vendim të kryetarit të Bashkisë.

**Neni 17**
**Mbajtja e dokumentave**

Subjekti i paisur me lejen e shfrytëzimit duhet të mbajë dokumentet në ambjentet që ushtron aktivitetin. Mos mbajtja e dokumenteve në mënyrë të përsëritur konsideohet si shkelje dhe gjobitet me gjobë. Përsëritja në mënyrë të vazhdueshme e shkeljes bëhet shkak për heqjen e lejes se shfrytëzimit.

**Neni 18**
**Sanksionet**

1. Ne momentin e konstatimit të zënies së hapësiRës publike, subjekti gjobitet me gjobë sipas kundravajtjes përkatëse në vlerën:

   a) Ekspozim Malli - 5 000 lekë
   b) Veprimtari të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike – 10 000 lekë
   c) Shërbim me tavolina jashtë lokalit - 20 000 lekë.

## Neni 19
## Specifikime dhe plan vendosje

Specifikimi i distancave, vendeve, mënyrave korrekte, të lejuara të shfrytezimit të hapesires publike, ilustrohen, shpjegohen në skicat e mëposhtme.




Figure 1 *Hapësira minimale e nevojshme, që të mos cenojë të drejtën e lëvizjes së kalimtarëve në rastin kur trotuari/hapësira publike është deri në 5 m.*

Në Figurën1,është paraqitur distanca minimale që duhet të ketë hapësira publike në mënyrë që subjekti privat, të ketë të drejtën ta shfrytezojë atë duke vendosur një rresht tavolinash pa cënuar të drejtën e kalimit dhe qarkullimit të qytetarëve në trotuar.

- a=1.5 m, është shënuar hapësira standart, e zënë nga një tavolinë për katër persona,
- në çdo rast hapësira e shfrytëzuar nuk duhet të shtrihet në gjatësi më shumë se fasada e objektit ku subjeti ushtron aktivitetin.
- b=2 m, hapësira minimale e levizjes për qytetarët, e cila në asnjë mënyrë nuk duhet të cënohet.
- c=1.5 m, është hapësira në të cilën përfshihet gjelbërimi i rrugës, ambjentet e shërbimit dhe funksionale ndërmjet tyre.




Figure 2 *Hapësira minimale e nevojshme, që të mos cenojë të drejtën e lëvizjes së kalimtarëve në rastin kur trotuari/hapësira publike është deri në 7 m.*

Në fig.2, është paraqitur distanca minimale që duhet të ketë hapësira publike, në mënyrë që, subjekti të ketë të drejtën ta shfrytezojë atë duke vendosur dy rreshta tavolinash pa cënuar të drejten e kalimit dhe qarkullimit të qytetarëve në trotuar.

- a=3.5m, është shënuar hapësira standarte, e zënë nga dy tavolina me katër përsona dhe hapësira ndërmjet tyre.
- në çdo rast hapësira e shfrytëzuar nuk duhet të shtrihet në gjatësi më shumë se fasada e objektit ku subjeti ushtron aktivitetin.
- b=2.5m, hapësira minimale e lëvizjes për qytetarët, e cila në asnjë mënyrë nuk duhet të cënohet.
- c=1.5 m është hapësira në të cilën përfshihet gjelbërimi i rrugës, ambjentet e shërbimit dhe funksionale ndërmjet tyre.

## Raste Specifike:

a) ***Lejushmeria korrekte e aksesit, në objektet multifunksionale***




Figure 3 *Lejushmeria korrekte e aksesit, në objektet multifunksionale*

b) ***Lejushmëria e lëvizjes normale, e qytetarëve në rruget e shërbimit ndërmjet dy objekteve.***




Figure 4 *Lejushmëria e lëvizjes normale, e qytetarëve në rruget e shërbimit ndërmjet dy objekteve.*

**Neni 20**
**Përjashtime**

Përjashtohen nga kjo rregullore të gjitha subjektet në rastet e përdorimit të hapësirës publike që përjashtohen me VKB nr.1 datë 22.1.2016 “për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”.

**Neni 21**
**Miratimi i hapësirës publike**

1. Miratimi i hapësirës publike behet bazuar në planin, bashkangjitur kësaj rregullore.

2. Për ndryshimin dhe miratimin e ketij plani për shfrytëzimin e hapësirave publike bëhet me vendim të kryetarit të bashkisë.

**Neni 22**
**Anekset**

Shtesat dhe ndryshimet ne kete rregullore bëhen me vendime të Kryetarit të bashkisë dhe quhen aneks i kësaj rregullore.
Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje jane:

a) Aneksi: Përcaktimet dhe specifikimet teknike për zënien e hapësirës publike në rrugët historike a) Rr “13 Dhjetori”, b)Rr. “28 Nentori” dhe c) Rr.“Kolë Idromeno”.

**Neni 22**
**Zona të rëndësisë historike dhe arkitektonike**

b) Zona të cilat kanë trajtime të posaçme ligjore konsiderohen zonat historike dhe arkitektonike dhe bëhen studime të posaçme.
c) Zona historike dhe arkitektonike konnsiderohen: a) Rr “13 Dhjetori”, b)Rr. “28 Nentori” dhe c) Rr.“Kolë Idromeno”.
d) Në rastet e studimeve pjesore të këtyre zonave, ato konsiderohen anekse të këtij vendimi.

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:10000



## LEGJENDA

- HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M
- HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M
- HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M
- HAPËSIRA TREG I MIRATUAR

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000




## LEGJENDA

- HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M
- HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M
- HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000




## LEGJENDA

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000




## LEGJENDA

- HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M
- HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M
- HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



V

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



V

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000




## LEGJENDA

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000




## LEGJENDA

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



V

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000




**LEGJENDA**

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000




## LEGJENDA

- HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M
- HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M
- HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000




**LEGJENDA**

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

V

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



V

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



V

# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE
SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



# HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000

V



V

# HAPËSIRA PUBLIKE  PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE

SH 1:1000



HAPËSIRA PUBLIKE PËR VENDOSJEN E TAVOLINA TË BAR-KAFEVE
SH 1:1000




**LEGJENDA**

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 5M ≤ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI ME GJERËSI ≥ 7.5M

HAPËSIRA TROTUARI PËR PEME ME GJERËSI 1.5 M

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +355222400150*

**ANEKSI**

**Percaktimet dhe specifikimet teknike per zenien e hapesires publike, ne rruget historike; per rruget "13 Dhjetori", "28 Nentori" dhe "Kole Idromeno".**

Ne Kuader te Rregullores **"Për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike",** per rruget "13 Dhjetori", "28 Nentori" dhe "Kole Idromeno", eshte bere projekt, studim i vecante duke patur parasysh, karakterin arkitektonik dhe rendesine historike qe rruget respektive, kane.
Ky Projekt realizohet ne perputhje me te gjitha distancat minimale te nevojshme, te specifikuara ne rregullore, konkretisht, skemat nje dhe dy, sikurse ne rrespekt te,

- Ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- VKM. Nr. 1096 datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike"

**1. Koncepti ''Dehors'', ne kontekstin urban**

Sistemi qe ne propozojme ''Dehors'', eshte nje tipologji modulare, e cila mund te prodhohet ne pozicione te ndryshme, te pershtatet ne cdo rrethane gjeometrike dhe tipologjie te kontekstit urban, ne menyre qe te limitoje shfrytezimin e improvizuar, te pamenduar mire te hapesires publike.
Struktura ''DEHORS'' eshte e dallueshme fale nje strukture te lehtesuar, eshte nje element kontemporan i krijuar fillimisht si koncept me dimensione dhe materiale uniforme.

Ne te njejten kohe, kjo strukture vendoset ne kontekstin urban duke respektuar normat e pozicionimit dhe te dimensionimit, duke respektuar standartet e kerkuara nga pushteti vendor per levizjen ne hapesirat publike, por nje rendesi te vecante i jepet dhe aspektit vizual te struktures respektive si dhe vendosjes se saj korrekte ne kontekstin urban.

Gjithashtu vendosja e ketij elementi ne nje zone te caktuar duhet te respektoje normat per zonen historike, dhe te integrohet ne planet urbane te saj duke u konsideruar si element i saj.



Figure 1 Shembull “Dehors”

Propozohet, nje sistem strukture modulare, i cili mund te perseritet ne pozicione te ndryshme ne qytet, kryesisht ne akset kryesore te tij dhe ne zonen pedonale, me dimensione te reduktuara, duke u dalluar keshtu edhe nga elementet perberes te saj, fale mundesise per nje montim te shpejte, te struktures metalike.

Ne rastin ne fjale, propozohet, nje strukture e lehte metalike, me dysheme, pod, qe do te realizohet me ECO-dru. Materiali I perbere quhet WPC dhe krijohet nga druri natyral I trajtuar me elemente kimik rezistente per te duruar kushteve atmosferike te jashteme dhe agjenteve biologjik. Ngjyra kromatike qe lejohet te perdoret, eshte ajo kafe e erret.

Moduli respektiv ka dimensionet 360 cm x 750 cm, duke bere te mundur organizimin e 8 (tete) tavolinave me kater karrige.

Mbulesa e ketyre strukturave modulare, do realizohet me ane te cadrave te ashtuquajtura, model kobra me dimensione 300 cm x 300cm.



Figure 2 Shembull Pod - Dysheme




Figure 3 Struktura Modulare

***Modul per aksesin per personat me aftesi te kufizuar (rrampa)***, eshte nje element pedane i realizuar me profile hekuri 40 x 20 x 2cm dhe 20 x 20 x 2cm i standartizuar dhe I projektuar me elemente ankorimi me strukturen e objektit. Pendenca e pedanes eshte prej 10% dhe ne baze dhe te normatives europiane per aksesin e personave me aftesi te kufizuara, shtrimi i saj duhet te realizohet me material jo rreshkites.

Subjekti, në perputhje me rregulloren dhe ligjet në fuqi, duhet të shfrytëzojë hapësirën publike, sipas miratimit të bëre,

a) duhet të riparojë me shpenzimet e veta të gjitha dëmtimet që rezultojnë nga përdorimi ose keqpërdorimi i hapësirës publike të dhënë;
b) të siguroje, me shpenzimet e veta dhe në kushte optimale sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim dhe atë rreth saj si nga ana e pastërtisë dhe funksionalitetit;
c) të kujdeset që objektet e vendosura në sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim të jenë në gjëndje të mirë si nga ana funksionale dhe ajo estetike (moduli “Dehors”)
d) të përdorë hapësirën publike znë menyrë të tillë që të mos kufizojë, shkaktojë dëme ose të shkelë të drejtat e paleve të treta;
e) të shmangë krijimin e situatave të rrezikshme ose të pengimit të qarkullimit të mjeteve dhe kalimit të këmbësorëve;
f) të bëje pagesën e tarifës brenda afateve të përcaktuara;
g) në momentin që subjekti nuk ka më të drejtë për shfrytëzimin e hapësirës publike si rrjedhoje e mos zbatimit të detyrimeve ose nëpërmjet kërkesës së tij, ta kthejë këtë hapësirë në gjëndje funksionale sic ishte para marrjes në dorëzim;
h) Ne rruget historike mund te shfrytezojne hapesiren publike, vetem subjektet bar / restorant. Nuk lejohet qe kjo hapesire te shfrytezohet per aktivitete te tjera, psh;

   - shites ambulant,
   - tregtim i artikujve te ndryshem,
   - loto / sport / baste

Albanian-American
Development Foundation

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

# RRUGA 13 DHJETORI - 28 NËNTORI

## *ZONA BID, SHKODER*



Albanian-American Development Foundation

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

# RRUGA 13 DHJETORI - 28 NËNTORI



Albanian-American
Development Foundation

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR








“Zona Historike - Rr. 13 Dhjetori - 28 Nëntori - Kole Idromeno, Shkodër “


3.5m








3.5m








Variant 1


3.6m
7.5m




200
750
320
350
300
150
300
180
200
350


Variant 1


3.5m




FOTO JAKOVA




NYMPHENBURG
NYMPHENBURG



# RRUGA KOLË IDROMENO

## *ZONA BID, SHKODER*



# RRUGA KOLË IDROMENO




750
360
320
300
150
300







Varianti 4



Varianti 5

*Modele Cadra*





